

Garat ekipore për vitin 2024

Më 14/04/2024, fillojnë garat ekipore në Superligën e Kosovës, në pingpong për vitin 2024, për meshkuj dhe për femra.

Superliga e femrave do të zhvillojë garat në palestrën e SHFMU Tefik Çanga, Ferizaj dhe në Prishtinë, ndërkah Superliga e meshkujve do të zhvillojë garat në Palestrën e pingpongut në Prishtinë dhe në Prizren.

Në vitin 2024, të gjitha garat ekipore do të organizohen me tubime në formë turneu ku për SUPERLIGA do të luhen jo më shumë se 2 xhiro brenda ditës, kurse për Ligat tjera me numër tek të xhirove, në njërën nga javët, do të zhvillohen 3 xhiro brenda ditës.

Garat e Superligës për meshkuj dhe femra do të zhvillojnë garat në Ferizaj dhe në Prishtinë (Femrat) kurse në Prishtinë dhe Prizren (meshkujt), dhe do të zhvillohen sipas sistemit me 4 të fituara (3 individuale dhe 1 në çifte, lejohen nga 3 deri në 5 lojtarë për një xhiro).

Garat e ligës së parë për meshkuj do të organizohen në Ferizaj dhe do të zhvillohen sipas sistemit me 3 të fituara (3 individuale, lejohen 3 ose 4 lojtarë për xhiro).

Garat e ligës së Parë për Femra do të organizohen në Pejë dhe do të zhvillohen sipas sistemit me 3 të fituara (3 individuale, lejohen 3 ose 4 lojtarë për xhiro).

Garat e ligës së dytë për meshkuj, janë ndarë sipas regjioneve në 3 Grupe:

Liga B- Ferizaj, Liga C- Pejë dhe Liga A, në Prishtinë, Bardh të Madh dhe në Skenderaj.

Garat do të zhvillohen sipas sistemit me 3 të fituara (3 individuale, lejohen 3 ose 4 lojtarë për xhiro), pas përfundimit të dy sezoneve do të organizohen garat e play off-it, ku 2 më të mirat nga secili grup do të garojnë secili me secilin për të caktuar 2 të parët që do të avancojnë në nivel më të lartë garues.

Garat e Ligës U19 vetëm për meshkuj, do të organizohen në Ferizaj, dhe do të zhvillohen sipas sistemit me 3 të fituara (3 individuale, lejohen 3 ose 4 lojtarë për xhiro).

Garat e ligës U15 për meshkuj, do të luhen në dy grupe:

Grupi A dhe B, do të organizohen në Ferizaj dhe do të zhvillohen sipas sistemit me 3 të fituara (2 individuale dhe 1 në çifte, lejohen 3 lojtarë për xhiro, secili luan maksimalisht 2 ndeshje për xhiro), pas përfundimit të dy sezoneve do të organizohen garat e play off-it.

